

Në përputhje me nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-209, GZ nr. 77/2010, 16 gusht 2010), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-150 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-209 Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/03 prill 2017), si dhe në përputhje me nenin 48 të Rregullores për Operacione me Para të Gatshme, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore, më datë 15 shkurt 2024, miratoi këtë:

UDHËZIM

**PËR LICENCË PËR OFRIM TË SHËRBIMEVE TË TRANSAKSIONEVE ME
PARA TË GATSHME PËRMES MAKINERIVE DHE PËR IMPORT TË KËTYRE
MAKINERIVE**



Neni 1 **Qëllimi**

Ky Udhëzim rregullon aspektet procedurale për marrjen e licencës së veçantë për ofrimin e shërbimeve të transaksioneve me para të gatshme të depozitimit apo të tërheqjes përmes makinerive që përdoren nga klienti, për institucionet financiare jo-bankare të regjistruara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës që operojnë në Republikën e Kosovës për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave dhe emetimin të parave elektronike si dhe aspektet procedurale të institucioneve financiare bankare dhe jo-bankare për importin e makinerive që përdoren nga klienti.

Neni 2 **Fushëveprimi**

1. Fushëveprimi i këtij Udhëzimi janë:

- 1.1. Aspektet procedurale të procesit të aplikimit dhe marrjes së licencës nga institucionet jo-bankare të cilat ushtrojnë veprimtarinë e shërbimit të pagesave dhe emetimin e parave elektronike dhe shërbime të transaksioneve me para të gatshme të depozitimit apo të tërheqjes përmes makinerive që përdoren nga klienti.
- 1.2. Aspektet procedurale të institucioneve financiare bankare dhe jo-bankare përkitazi me importin e makinerive që përdoren nga klienti.

Neni 3

Pranueshmëria e kërkesave për pajisje me licencë për shërbimet e depozitimit apo tërheqjes se parave të gatshme përmes makinave që përdoren nga klienti

Në përputhje me paragrafët 4 dhe 6 të Nenit 46 të Rregullores për operacione me para të gatshme, Institucionet financiare jo-bankare që janë të regjistruara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave dhe emetimit të parave elektronike, përveç institucioneve bankare që janë të licencuara për këtë aktivitet, duhet të marrin licencë shtesë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ofrimin e shërbimit të depozitimit apo tërheqjes se parave të gatshme, apo blerjen dhe ri-kthimin e parave elektronike përmes makinave që përdoren nga klienti.

Neni 4

Kërkesat për pajisje me licencë për shërbimet e depozitimit apo tërheqjes se parave të gatshme përmes makinave që përdoren nga klienti

1. Në përputhje me paragrafët 3 dhe 5 të Nenit 46 të Rregullores për operacione me para të gatshme, Institucionet financiare jo-bankare të regjistruara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave dhe emetimit të parave elektronike duhet të kërkojnë dhe pajisen me një licencë për ofrimin e shërbimeve të depozitimit apo tërheqjes se parave të gatshme përmes makinave që përdoren nga klienti.
2. Për t'u kualifikuar për një licencë për ofrimin e shërbimeve të depozitimit apo tërheqjes se parave të gatshme përmes makinave që përdoren nga klienti, një institucion financiar jo-bankar duhet të plotësojë kriteret minimale të mëposhtme:

- 2.1. Të jetë një institucion financiar jo-bankar i regjistruar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimit të pagesave dhe emetimit të parave elektronike në Republikën e Kosovës.
- 2.2. Institucion financiar jo-bankar duhet të sigurojë që makinat që përdoren nga klienti, që ofrojnë mundësinë e depozitimit të kartëmonedhave dhe/ose monedhave janë në gjendje të verifikojnë autenticitetin e kartëmonedhave dhe/ose monedhave, të gjurmojnë klientin, si dhe të jenë në gjendje që të konfiskojnë/tërheqin dhe të mos ja kthejnë klientit paratë e dyshuara si të falsifikuara.
- 2.3. Institucion financiar jo-bankar duhet të sigurojë që furnizimi me para të gatshme i makinave që përdoren nga klienti bëhet ekskluzivisht vetëm me kartëmonedha dhe/ose monedha të furnizuara nga institucionet financiare bankare që paraprakisht janë përpunuar me makineri moderne, në përputhje me të gjitha obligimet që dalin nga Rregullorja për operacione me para të gatshme.

Neni 5

Procesi i aplikimit për pajisje me licencë për shërbimet e depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme përmes makinave që përdoren nga klienti

1. Në bazë të vlerësimit të nevojave të vet institucionit financiar jo-bankar, parashtrohet një kërkesë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës për aplikim zyrtar për pajisje me licencë për ofrimin e shërbimeve të depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme përmes makinave që përdoren nga klienti, duke përkrahur, së paku:
 - 1.1. Emrin dhe adresën e institucionit financiar jo-bankar që parashtron kërkesën për licencë;
 - 1.2. Llojet e makinerive që përdoren nga klienti për të cilat kërkohet licenca:
 - 1.2.1. Makineri që ofrojnë shërbimin për depozitimin e parave të gatshme;
 - 1.2.2. Makineri që ofrojnë shërbimin për tërheqjen e parave të gatshme;
 - 1.2.3. Makineri që ofrojnë shërbimin për depozitimin dhe tërheqjen e parave të gatshme.
 - 1.3. Dëshmi se makineritë që përdoren nga klienti janë në gjendje të verifikojnë autenticitetin e kartëmonedhave dhe/ose monedhave dhe se janë në gjendje që të konfiskojnë, tërheqin dhe të mos ja kthejnë klientit paratë e dyshuara si të falsifikuara;
 - 1.4. Dëshmi se makineritë që përdoren nga klienti janë në gjendje të gjurmojnë klientin i cili kryen transaksionin.
2. Aplikimi shoqërohet me dokumentacionin mbështetës në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni dhe paraqiten pranë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
3. Aplikimet duhet të dorëzohen në Departamentin përgjegjës për Licencim pranë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
4. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të shqyrtojë aplikacionin dhe mund të kërkojë informata shtesë.
5. Koha e zakonshme e përpunimit të aplikacionit është deri në 3 muaj pas komentimit të dokumentacionit, përveç rasteve kur një kërkesë e tillë ka natyrën prioritare dhe dosja është e kompletuar plotësisht;

6. Nëse miratohet aplikimi, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të lëshojë një licencë me kushte dhe kufizime specifike.

Neni 6

Licencat për lejimin e ofrimit të shërbimeve të depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme përmes makinave që përdoren nga klienti

1. Varësisht kërkesës dhe aplikimit për pajisje me licencë për lejimin e ofrimit të shërbimeve të depozitimit apo tërheqjes së parave të gatshme përmes makinave që përdoren nga klienti, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mund të lëshojë licence në varësi të aktivitetit që kryen institucioni financiar jo-bankar.
2. Llojet e licencave të aplikueshme sipas këtij udhëzuesi janë:
 - 2.1. Licencë për lejimin e ofrimit të shërbimeve të depozitimit të parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti
 - 2.2. Licencë për lejimin e ofrimit të shërbimeve të tërheqjes së parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti
 - 2.3. Licencë për lejimin e ofrimit të shërbimeve të depozitimit dhe tërheqjes së parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti

Neni 7

Importi i makinerive që përdoren nga klienti

1. Në përputhje me paragrafin 3 të Nenit 47 të Rregullores për operacione me para të gatshme, Institucionet financiare bankare dhe jo-bankare duhet të sigurojnë që me rastin e importit të makinerive, të informojnë Doganat e Kosovës (qoftë në mënyrë direkte apo përmes kontraktuesit/importuesit/furnizuesit) përmes një shkrese të veçantë me anë të së cilës dëshmojnë se makina e tillë importohet për një institucion financiar bankar ose jo-bankar.
2. Shkresa që i drejtohet Doganave të Kosovës duhet të përmbajë se paku emrin e institucionit bankar ose jo-bankar për të cilin kryhet importi i makinerisë, furnizuesi i makinerisë, vendi prej nga importohet makineria, vendi i origjinës së makinerisë, emërtimi i makinës, lloji i makinës, modeli i makinës dhe prodhuesi i makinës.

Neni 8

Lista e institucioneve financiare bankare dhe jo-bankare që kanë të drejtë të kryejnë importimin e makinerive që përdoren nga klienti

1. Në përputhje me paragrafin 4 të Nenit 47 të Rregullores për operacione me para të gatshme, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të publikojë një listë të institucioneve financiare bankare dhe jo-bankare që kanë të drejtë të kryejnë importimin e makinerive që përdoren nga klienti
2. Lista e institucioneve financiare bankare dhe jo-bankare që kanë të drejtë të kryejnë importin e makinerive do të jetë e listuar në linkun e posaçëm <https://bqk-kos.org/liflim/>

Neni 9

Raportimi për listën e makinerive dhe furnizimit me para të gatshme të makinerive që përdoren nga klienti

1. Institucioni financiar jo-bankar duhet të raportojë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në baza gjashtë mujore për listën e makinerive që përdoren nga klienti. Informatat rreth makinerisë duhet të detajojnë llojin e makinës, prodhuesin, emërtimin e makinës, modeli, softueri dhe adresa e saktë e makinerisë.
2. Institucioni financiar jo-bankar duhet të raportojë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në baza gjashtë mujore për furnizimet e makinerive me kartëmonedha dhe/ose monedha të furnizuara nga institucionet financiare bankare të makinave që përdoren nga klienti. Informatat duhet të detajojnë llojin e makinës, datën e furnizimit, shumën e furnizuar, strukturën nominale dhe referencën e dokumentit burimor të lëshuar nga banka përkitazi me tërheqjen e parave të gatshme për furnizim të makinerisë.

Neni 10

Ruajtja e të dhënave dhe aspektet e tjera shtesë

1. Institucionet financiare jo-bankare duhet të mbajnë shënime të detajuara për të gjitha depozitimet dhe tërheqjet e parave të gatshme të realizuara në makineritë që përdoren nga klienti, dhe t'i raportojnë ato në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës sipas kërkesës.
2. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës mund të realizojë inspektime të rregullta me ose pa paralajmërim për të verifikuar pajtueshmërinë me ligjet dhe aktet nënligjore dhe për të siguruar praktika të sigurta të operacioneve me para të gatshme.

Neni 11

Shtojcat

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi është Shtojca 1.

Neni 12

Miratimi dhe hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi në datën e miratimit.



Ahmet Ismaili

Kryesues i Bordit Ekzekutiv

Shtojcë 1

[Kërkesë për licencë për lejimin e shërbimeve të transaksioneve të depozitimit apo të tërheqjes së parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti]

Logo e institucionit
jo-bankar

Datë: [Data e kërkesës]

Nga	[Emri i Institucionit jo-bankar]
	[Adresa e plotë e Institucionit jo-bankar] [Qyteti i Institucionit jo-bankar] Republika e Kosovës
Për	Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës
	33 Garibaldi 10000, Prishtinë Republika e Kosovës
Departamenti	Departamenti i Licencimit dhe Standardizimit
Tema	Kërkesë për licencë për lejimin e shërbimeve të transaksioneve të depozitimit apo të tërheqjes së parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti

RE: Të nderuar,

Në përputhje me paragrafin 4 të Nenit 46 të Rregullores për operacione me para të gatshme, përmes këtij aplikimi kërkojmë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës të na pajisë me licencë për llojin e licencës të zgjedhur në tabelën e mëposhtme për lejimin e shërbimeve të transaksioneve të depozitimit apo të tërheqjes së parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti:

Lloji i kërkesës për licencë

Licencë për lejimin e ofrimit të shërbimeve të depozitimit të parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti	
Licencë për lejimin e ofrimit të shërbimeve të tërheqjes së parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti	
Licencë për lejimin e ofrimit të shërbimeve të depozitimit dhe tërheqjes së parave të gatshme përmes makinerive që përdoren nga klienti	

* zgjidhni vetëm një opsion

Bashkangjitur: Dokumentacioni mbështetës

Me respekt

[Emri i personit të autorizuar të institucionit jo-bankar]

[Fjalë dhe adresë kontaktuese]